




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK
Dep.	
Dep.	
Nr. i fag	
Broj stranica	02
Nr. pages	
Nr. Prot.	01-3487/15
Bz. Prot.	
Prot. No.	
Data	
Datum	22.10.2015
Date	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 22.10.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me nr AKK-03-02-2667/15, për znj. Mimoza Kusari - Lila, Kryetare e Komunës së Gjakovës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e cilësojnë situatën me konflikt interesit, por ka disa kufizime.

II. Rasti mund të rihaqet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtimin e Funksionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Mimoza Kusari - Lila, Kryetare e Komunës së Gjakovës, dhe njëkohësisht, Anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit Publik "Fehmi Agani" në Gjakovë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartpërmendur, zyrtarja e lartë znj. Kusari – Lila, është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtimin e funksioneve publike si Kryetare e Komunës së Gjakovës, dhe njëkohësisht Anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit Publik "Fehmi Agani" në Gjakovë.

Zyrtarja e lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Zyrtarët e Agjencisë kanë organizuar një takim me zyrtaren e lartë për ta njoftuar për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilin ndodhej. Zyrtarja e lartë ka dekluaruar se në funksionin e Anëtares së Këshillit Drejtues është emëruar me Vendim të Ministrit të Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë duke u bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë Nr.04/L-037.

Në Ligjin për Arsimin e Lartë Nr.04/L-037, te struktura qeverisëse e bartësve të arsimit të lartë, në nenin 18 (paragrafi 2), ndër të tjera thuhet se Anëtarët e këshillit Drejtues duhet të jenë persona me reputacion të lartë publik, me aftësi përkatëse profesionale, afariste si dhe me aftësi të tjera praktike. Asnjë nga anëtarët e emëruar nuk duhet të ketë lidhje të drejtpërdrejta aktuale me institucionin në të cilin emërohet.

Në bazë të fakteve dhe provave kemi konstatuar se nuk ka situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, por ka disa kufizime dhe obligime që rrjedhin nga Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nen 15 (paragrafi 3), i po këtij ligji parashev kufizimin gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve. Në këtë nen shprehimisht thuhet: “Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organeve drejtuese dhe mbikëqyrës i personave juridik jo fitimprurës dhe personave juridik tjerë të cilat kryejnë pune nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarive humanitare, por nuk ka të drejtë të pranimit te kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme, për veç nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera”.

Zyrtarja e lartë znj. Kusari - Lila është i obliguar që gjatë ushtrimit të funksionit publik të bëjë deklarimin rast për rast të interesave private lidhur me ndonjë vendimmarrje të caktuar nen 13 (paragrafi 1,2,3) të Ligjit nr. 04/L-051.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

